

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ FASHION EMBROIDERY “ shpk**

Ne perputhje me ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008,“Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ,Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijohet shoqeria tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **“FASHION EMBROIDERY “shpk**

***KREUI***

***Neni 1***

***Emertimi***

Shoqeria do te emertohet **“ FASHION EMBROIDERY “ shpk** dhe eshte person juridik i te drejtes shqiptare,

***Neni 2***

***Personaliteti juridik***

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **“ FASHION EMBROIDERY “ shpk** është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaku i vetem, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

***Neni 3***

***Selia***

Shoqeria e ka seline ne Fier , ne adresen Lagja ‘Kryengritja e Fierit’, Ish Uzina E pambukut, godina nr 8/89 ,Fier .

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

***Neni 4***

***Objekti i veprimtarise***

Import-eksport te materialeve tekstile,konfeksioneve,makineri e pajisje qepese te tekstileve,perpunim,konfeksionim e qepje dhe tregtim me shumice e pakice i konfeksioneve. Te merret me transaksione financiare nga Shqiperia per jashte dhe nga jashte per ne Shqiperi.Te merret me promovimin e shkembimeve tregtare nga Shqiperia per jashte dhe nga jashte per ne Shqiperi.Te merret me terheqjen e investimeve dhe te investitoreve te huaj ne Shqiperi.Te merret me ofrimin e sherbimeve keshillimore per investitoret e huaj.Te merret me studimin dhe

prezantimin e mundesive te mira per biznes dhe aktivitetete investuese ne Shqiperi. Te merret me ofrimin e ndihmave teknike dhe ligjore per kompanite e huaja qe duan te investojne ne Shqiperi vecanerisht ne fushen e infrastruktures(konfeksione te te gjitha llojeve,ndertim,energji,burimet ujore etj.)

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

*KREU II*  
*KAPITALI*

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 leke  
Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem" i shoqerise :

**z.Salvatore My**, zoterues i 1 (nje ) kuote , me vlere te pergjithshme 100 leke  
qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.  
Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)  
Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise; Kapitali i shoqerise do te hidhet ne Banke pasi te dali NIPTI i shoqerise .

Neni 7


Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.



*Handwritten mark*

9723, datë 3.5.2007 'Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit'. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## *KREU II*

### *ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE*

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 9

##### Administrimi

Administrator i shoqerise eshte z.Salvatore My , atesia My Rosario, i datelindjes 23.08.1971, lindur ne Nardo Itali, shtetas Italian madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjofimit te shtetit italian me nr AS0670883 , emeruar ne kete detyre per nje afat 5 vjecar me te drejte ripërtëritje.

„Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

*Lib*

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetem edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.


Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12



Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetëm;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

#### Neni 13

#### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 14


#### Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplare në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mesipër pasi miratohet në parim dhe nën parim nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "FASHION EMBROIDERY" shpik nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale .

ORTAKU I VETËM

My Salvatore



Abas Hazeli  
Abas

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE VLORE  
NOTERE FLORA XH.ZOTO  
Nr. 1354 Rep.



*VERTETIM NENSHKRIMI*

Ne Fier, sot me date 07.04.2016 (gjashtembedhjete) perpara meje Flora Zoto , Noteres Publike, anetare e Dhomes se Notereve Vlore, u paraqite personalisht shtetasi me keto identitete :

- Salvatore My, atesia My Rosario, i datelindjes 23.08.1971, lindur ne Nardo Itali, shtetas Italian madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar prej meje noteres me leternjoftim te shtetit italian me nr AS0670883.

I cili me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "FASHION EMBROIDERY " SHPK , deklaroi se statuti i mesiperm eshte hartuar sipas vullnetit te tij jashte kesaj zyre, ne gjuhen shqipe dhe i eshte perkthyer akti nga perkthyesi i gjuhes Italiane Arbana Zarka, e njohur personalisht prej meje noteres dhe e nenshkruan regullisht perpara meje noteres dhe une vertetoj sipas ligjit autenticitetin e firmave orgjinale te tij

**NOTERE  
FLORA XH.ZOTO**